
Raport per

MONITORIMIN E PUNËS SË KËSHILLIT GJYQËSOR

Janar - Korrik 2024



Financuar nga Bashkimi Evropian

Instituti për të drejtat e njeriut

Titulli:

RAPORT PËR MONITORIMIN E PUNËS SË KËSHILLIT GJYQËSOR
Janar - Korrik 2024

Botues:

Shoqata e qytetarëve Instituti për të drejtat e njeriut Shkup

Skopje, Gusht 2024

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropia.

PËRMBAJTJE

HYRJE **4**

TRANSPARENCA E KËSHILLIT GJYQËSOR **4**

Votimi dhe sistemi i regjistrimit të zërit **5**

Seanca publike të KGJRMV-së **5**

Raporte vjetore mbi punën e KGJRMV-së **6**

Prania e anëtarëve, me detyrë, në seancat e KGJRMV-së **6**

Analizë e përmbajtjes së publikimeve të Këshillit Gjyqësor dhe deklaratave për media **6**

Hapja ndaj publikut dhe medias **7**

EFEKTIVITETI DHE EFIKASITETI I KËSHILLIT GJYQËSOR **8**

Zbatimi i rekomandimeve të Misionit Vlerësues të BE-së **8**

Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve **9**

Vendim mbi kërkesën për heqjen e imunitetit dhe miratimin e paraburgimit **11**

Zgjedhja e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave **12**

Shkarkimi i gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave **15**

Monitorimi i punës së gjykatave **15**

Vendimmarrje për parashtresat nga qytetarët dhe personat juridikë **16**

PËRFUNDIME **18**

REKOMANDIME **19**

HYRJE



јануари - јули 2024 година

Instituti për të Drejtat e Njeriut, nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha seancat e hapura, rregullisht monitoron punën e Këshillit Gjyqësor. Qëllimi i këtij aktiviteti është që, duke monitoruar objektivisht punën e Këshillit Gjyqësor, Instituti për të Drejtat e Njeriut të evidentojë sfidat dhe progresin në punën e tij, si dhe të kontribuojë, me konkluzione dhe rekomandime të bazuara në prova, në përmirësimin e situatës në gjyqësor. Ky aktivitet realizohet në kuadër të programit "Qasje në drejtësi për të gjithë", financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të programit IPA III për shoqërinë civile dhe mediat 2022.

Raporti i monitorimit të punës së Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut i referohet periudhës nga janar deri korrik 2024.

Ky raport është i ndarë në tri pjesë kryesore të cilat lidhen respektivisht me **transparencën, efektivitetin dhe efikasitetin e Këshillit Gjyqësor.**



TRANSPARENCA E KËSHILLIT GJYQËSOR



23 sessions held

Gjatë kësaj periudhe, KGJRMV ka zhvilluar **23 seanca, njëra prej të cilave ishte në dy vazhdime.** Publikimi i informacionit për seancat e planifikimit ishte kryesisht në kohë. **Mund të vërehen edhe disa seanca urgjente, njëra prej të cilave është absolutisht e justifikuar, për shkak të afateve kohore, dhe i referohet përcaktimit të paraburgimit për gjyqtarin që u kap gjatë kryerjes së një krimi nga pjestarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme.**

Menjëherë pas përfundimit të secilës prej seancave, publikohen njoftimet për vendimet dhe konkludimet e arritura, dhe, ndryshe nga më parë, mund të vërehen njoftime më të gjera në lidhje me pikat e diskutuara në çdo seancë, si dhe njoftime për vendimet e marra. Këshilli Gjyqësor duhet ta ruajë këtë praktikë në periudhën e ardhshme për të përmirësuar transparencën e tij aktive.

Vazhdon transmetimi i drejtpërdrejtë i seancave nga Agjencia Informative e Maqedonisë. Kjo praktikë u prezantua në maj 2023, por mediat e tjera shpesh janë të pranishme, si dhe gazetarë dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare që raportojnë mbi seancat. Gjatë kësaj periudhe është rritur edhe interesimi, si për seancat, ashtu edhe për veprimet e KGJRMV-së.

Është respektuar detyrimi ligjor për publikimin e procesverbaleve të seancave të KGJRMV-së. Procesverbalet janë të detajuara dhe janë publikuar pas miratimit. Gjatë kësaj periudhe kohore, vërehet miratimi i rregullt dhe publikimi i tyre në faqen e internetit të KGJRMV-së. Për një kohë të gjatë ndodh praktikë e paunifikuar e përgatitjes së tyre. Pa-

varësisht vërejtjeve nga kryetarja dhe disa anëtarë, ende nuk është prezantuar një praktikë e unifikuar për përgatitjen e procesverbalit dhe paraqitjen e informacionit, gjë që çon në reagime nga anëtarët e KGJRMV-së për mënyrën e përgatitjes së tyre nga shërbimi profesional. Duket se mungon vullneti i shërbimit profesional për të unifikuar mënyrën e përgatitjes të tyre. Gjithashtu, disa anëtarëve të KGJRMV-së iu kërkua, nga të cilët të gjithë pranuan, të përfshinin listën e votimit si pjesë e procesverbalit. Kjo është kërkuar për shkak të transparencës më të madhe në mënyrën e votimit të anëtarëve, por për arsye teknike, KGJRMV ende nuk mund ta zbatojë plotësisht këtë konkluzion.

VOTIMI DHE SISTEMI I REGJISTRIMIT TË ZËRIT

Në këtë periudhë raportuese funksiononte sistemi elektronik i regjistrimit të zërit dhe i votimit, ashtu që anëtarët votonin përmes sistemit të votimit, e cila është një mënyrë e rregullt e votimit, përveç në raste kur ndonjëri prej anëtarëve ngre dyshime për rezultatin, me ç'rast mund të kërkojë votim me ngritje të dorës.

SEANCA PUBLIKE TË KGJRMV-SË

Sa i përket dinamikës së mbajtjes së seancave, në baza mujore, dy deri në tre seanca janë mbajtur gjatë një muaji, dhe një seancë ka qenë gjithmonë e rezervuar për të vendosur për parashtresat e qytetarëve dhe personave juridikë, që gjithashtu është një detyrim ligjor.

Praktika e mbajtjes së kolegiumeve para fillimit të seancave, gjë që ishte rregull në periudhën e mëparshme, tani është ndërprerë, në mënyrë që të mos ketë asnjë vonesë në fillimin e seancave publike për shkak të mbajtjes së kolegiumeve ose takimeve të punës. Në këtë drejtim, mund të theksohet vullneti i kryetares të KGJRMV-së për të mos caktuar më seanca urgjente, të cilat për nga natyra e tyre nuk janë në të vërtetë urgjente, ndërsa kjo praktikë në të kaluarën ishte e zakonshme dhe përdorej për të marrë vendime me sa më pak prani publike.

Seancat publike të KGJRMV-së dhe puna e anëtarëve janë të gjera, me shumë pika në rendin e ditës, ku mund të shënohet pjesëmarrja aktive në diskutimet e të gjithë anëtarëve, duke përdorur të drejtën e përgjigjes, argumentimit, justifikimit, me interpretime të ndryshme të situatave të caktuara që janë diskutuar më parë dhe mbi të cilat tashmë janë arritur konkluzione ose sqarime të disa procedurave që nuk janë shpjeguar sa duhet. Por ndonjëherë ka diskutime më intensive, gjë që jep përshtypjen se anëtarët e bindin njëri-tjetrin se argumentimi i cilit është më i ligjshëm, veçanërisht kur ka pikëpamje të ndryshme për situatat e diskutuara më parë që nuk përcaktohen me ligj. U konstatuan edhe mendime të veçuara të anëtarëve, të cilat publikohen në ueb-faqen e KGJRMV-së, ndërsa në seanca deklarohet gjithnjë e më shpesh përgjegjësia individuale e anëtarëve, pavarësisht se është organ kolektiv që vendos me shumicë votash. Diskutimet zgjatën për një kohë të gjatë dhe nuk u respektua Rregullorja e punës së KGJRMV, në të cilën është përcaktuar se si dhe sa mund të diskutojë secili anëtar për një çështje të caktuar. Shpesh, nga kryetarja, u theksua zbatimi i dispozitave të punës që kufizojnë diskutimet e anëtarëve, për hir të diskutimeve efikase

dhe efektive, pa u përsëritur anëtarët disa herë në mënyrë të panevojshme, me deklarata të njëjta ose të ngjashme pas pikës për të cilën është zhvilluar diskutimi.

Ndryshe nga më parë, kur anëtarët nuk ishin dakord për një pikë të caktuar me propozimin e dhënë për vendim, ata tani japin shpjegime specifike për arsyet e mospajtimit të tyre me propozimin dhe mjaft shpesh japin propozime të reja me argumentime për vendosje për një pikë të caktuar që diskutohej në seancë.



RAPORTE VJETORE MBI PUNËN E KGJRMV-SË

Raporti vjetor për punën e KGJRMV-së për vitin 2023 u dorëzua në Kuvend brenda afatit të përcaktuar ligjërisht[1] më 25.4.2024, por ende nuk është futur në rendin e ditës të seancës plenare.



PRANIA E ANËTARËVE, ME DETYRË, NË SEANCAT E KGJRMV-SË

Në këtë periudhë raportuese, Ministri i Drejtësisë nuk ka qenë i pranishëm në asnjë seancë të KGJRMV-së, megjithëse ai dhe kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë anëtarë me detyrë në Këshillin Gjyqësor të cilët mund të marrin pjesë në seancat e KGJRMV-së, por janë pa të drejtë vote.

Kryetarja e GJSRMV-së mori pjesë në seanca, ndërsa mungesën e saj ajo e justifikoi duke qenë shumë e zënë me çështjet aktuale si kryetare e gjykatës më të lartë në vend. Në seancat ku ka marrë pjesë ka qenë aktive me dhënie të mendimeve, vërejtje, propozime dhe sugjerime për çështje të caktuara të vendosura në rendin e ditës. Në këtë periudhë kohore, ka edhe përmirësim të marrëdhënieve të ndërsjella të dy institucioneve, dhe më e rëndësishmja, ka një zgjidhje pozitive të procedurës së iniciuar të përgjegjësisë së kryetares të GJSRMV-së. Gjegjësisht, KGJRMV-ja nuk e mbështeti raportin e Komisionit për ngritjen e përgjegjësisë së kryetares të GJSRMV-së. Kjo procedurë filloi në nëntor 2023 dhe u ndoq nga afër nga publiku.



ANALIZË E PËRMBAJTJES SË PUBLIKIMEVE TË KËSHILLIT GJYQËSOR DHE DEKLARATAVE PËR MEDIA

Në periudhën kohore të mbuluar nga ky raport, siç mund të shihet nga faqja e internetit e KGJRMV-së, pas kthimit të kryetares Vesna Dameva në detyrë, mund të vërehet rritja e komunikimit të KGJRMV-së me publikun e gjerë. Ndryshe nga periudha e mëparshme, mund të vëzhgohen takime intensive me ambasadorë dhe me institucione vendase nga sektori i drejtësisë, organizata joqeveritare, takim i realizuara me përfaqësues të grupit Blueprint dhe brifing të organizuar me mediat. Me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit me insti-

1 https://www.sobranie.mk/detali-na-materijal.nspx?param=39a30df8-b2ac-4133-a706-915071aa5a7c

tucionet, u zhvilluan takime dhe u nënshkruan disa memorandume bashkëpunimi me Shoqatën e Avokatëve, Odën e Noterëve dhe Odën e Përmbaruesve.

Të dukshme janë postimet rreth vizitave dhe pjesëmarrjes në konferenca në të cilat kryetarja ka mbajtur fjalimin.

Në kuadër të projektit "Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit", mbështetur financiarisht nga Delegacioni i BE-së në Shkup, u mbajt një Konferencë për të vlerësuar progresin në zbatimin e rekomandimeve të Misionit Vlerësues të BE-së mbi sfidat me të cilat përballet Këshilli Gjyqësor, aktivitetet e deritanishme dhe aktivitetet që do të ndërmerren nga Këshilli në periudhën e ardhshme në mënyrë që të zbatohen rekomandimet e Misionit Vlerësues. Në të njëjtën kohë, në këtë konferencë, u prezantua Strategjia e Komunikimit të Këshillit Gjyqësor dhe Gjykatave (2024-2028), e zhvilluar në bashkëpunim me përfaqësuesit e grupit Blueprint për reforma në gjyqësor, median dhe përfaqësues të tjerë nga gjykatat dhe sektori i drejtësisë.

Mund të konkludohet se transparenca e KGJRMV-së ndaj publikut të gjerë është përmirësuar në drejtim të informacionit më të shpeshtë dhe më të detajuar që ndahet jo vetëm për kompetencat e drejtpërdrejta të KGJRMV-së, por edhe për aktivitetet e tjera të ndërmarra nga kryetarja dhe anëtarët e KGJRMV-së drejt një hapjeje më të madhe ndaj qytetarëve. Sidoqoftë, faqja aktuale e internetit e KGJRMV-së nuk është mjaft e lehtë për t'u kërkuar dhe nuk lejon kërkim të lehtë të dokumenteve dhe publikimeve. Në të njëjtën kohë, për të rritur dukshmërinë e punës së Këshillit Gjyqësor në ushtrimin e kompetencave të tij, është e nevojshme të publikohen më shpesh njoftime nga aktivitetet e përditshme, të cilat i referohen qëllimit të tyre kryesor për të siguruar pavarësinë e gjyqësorit, si dhe njoftime për problemet dhe aktivitetet aktuale që KGJRMV ndërmerr për t'i zgjidhur ato.



HAPJA NDAJ PUBLIKUT DHE MEDIAS

Gjatë periudhës në të cilën është monitoruar puna e KGJRMV-së, ka pasur interesim të vazhdueshëm për punën jo vetëm nga mediat, por edhe nga OJQ-të dhe publiku i përgjithshëm. Njoftimet janë më të gjera dhe me më shumë informacion në lidhje me pikat në rendin e ditës dhe dokumentet që miratohen publikohen menjëherë. Seancat e KGJRMV-së nga agjencia mediatike AIM transmetohen drejtpërdrejt, por ndryshe nga më parë, ky shërbim është me pagesë.

Në janar, KGJRMV festoi 30 vjet nga themelimi i saj. Ky jubile i rëndësishëm u shënua në mënyrë modeste duke paraqitur punën e KGJRMV-së deri më tani në Sesionin Publik, në të cilin kryetarja kishte ekspozenë e saj.

Me rastin e Ditës së Gjyqësorit - 31 Mars, KGJRMV organizoi një ditë të hapur për qytetarët, me qëllim që të mund të njihen me kompetencat dhe aktivitetet dhe të komunikojnë drejtpërdrejt me kryetaren dhe anëtarët.

EFEKTIVITETI DHE EFIKASITETI I KËSHILLIT GJYQËSOR

ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË MISIONIT VLERËSUES TË BE-SË

Rekomandimet e paraqitura në Raportin e Misionit Vlerësues të BE-së në vitin 2023, duke iu referuar përmirësimit të situatës në KGJRMV dhe gjyqësorin në tërësi, u pranuan nga KGJRMV me miratimin e Planit të Veprimit për zbatimin e tyre. Ky plan, si dhe disa dokumente të tjera, u hartuan përmes projektit "Mbështetja e BE-së për sundimin e ligjit" në të cilin morën pjesë në mënyrë aktive të gjithë anëtarët e KGJRMV-së, duke demonstruar vullnetin për zbatimin e tyre të plotë dhe në kohë, në veçanti rekomandimet në lidhje me punën e tyre dhe të cilat ishin menjëherë të zbatueshme, pa nevojën e ndryshimit legjislativ ose kushtetues.

Në përputhje me Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, përmes një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës, u hartua dhe u miratua Strategjia e Komunikimit e KGJRMV-së dhe gjykatave të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me një Plan Veprimi me të cilin u miratuan standardet për komunikimin e gjyqësorit me publikun e gjerë.

Pjesë e rekomandimeve të Misionit Vlerësues, për të cilin është kritikuar prej kohësh KGJRMV, është shpjegimi i vendimeve për emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave. Në bazë të këtyre rekomandimeve, KGRJMV miratoi Rregulloren e punës për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës së KGJRMV, me të cilat u bënë ndryshime cilësore, dhe ka të bëjë me shpjegimin e vendimeve të anëtarëve të KGJRMV-së kur votojnë kundër zgjedhjes së një gjyqtari të caktuar, ndryshe nga deri më tani, kur ata jepnin shpjegim vetëm për votimin pozitiv për një gjyqtar të caktuar. Pastaj, u bënë ndryshime me të cilat vendimet do të individualizohen, me standarde objektive, qëndrueshmëri dhe krahasueshmëri të arsyetimit për përzgjedhjen, gjegjësisht, mosgjedhjen e gjyqtarit. Në funksion të procedurës së azhurnuar, parashikohen afate për të vepruar në të gjitha fazat e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së një gjyqtari ose kryetari të një gjykate, , dhe për të zbatuar një rekomandim në Raportin e Misionit Vlerësues të BE-së, Shoqata e Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe organizatat e shoqërisë civile parashikohen gjithashtu të përfshihen në diskutimin dhe miratimin e Raportit Vjetor për punën e KGJRMV-së.

Për më tepër, pjesë e rekomandimeve të zbatuara është miratimi i Rregullores për ndryshimin e Rregullores për mënyrën e renditjes së kandidatëve për zgjedhje në një gjykatë më të lartë, përmes së cilës vlerësimi u rafinua me qëllim të zgjedhjes së gjyqtarëve në një gjykatë më të lartë, në përputhje me rezultatet e tyre reale cilësore, të cilat rezultuan nga procesi i tashmë i kryer i vlerësimit të rregullt të gjyqtarëve. Gjithashtu, ndryshimet parashikojnë që çdo punë shtesë e gjyqtarëve të merret parasysh gjatë vlerësimit të tyre, përfshirë referimin e përkohshëm nga një gjykatë në tjetrën. Element i rëndësishëm është vendimi për zbatimin e këtyre ndryshimeve gjatë publikimit të shpalljeve të reja për zgjedhjen e gjyqtarëve, si dhe për zbatimin e procedurave aktuale sipas Rregullores së datës 4.2.2020.

Si pjesë e përmirësimit të akteve nënligjore të KGJRMV-së, miratimi i Udhëzimeve për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimeve për Metodën e Llogaritjes së Orarit Efektiv të Punës është gjithashtu pjesë e përmirësimit të akteve nënligjore të KGJRMV-së, me qëllim që të sigurohet një vlerësim real i punës së gjyqtarëve.

Të gjitha këto ndryshime të miratuara në disa dokumente duhet të jenë bazë për përmirësimin e transparencës thelbësore të KGJRMV-së, e cila do të ndikojë drejtpërdrejt në funksionimin efektiv të tyre dhe do të nënkuptojë forcimin e besimit, jo vetëm tek qytetarët, por edhe tek vetë gjyqtarët, por mbetet të shihet se si do të zbatohen këto ndryshime në të ardhmen.

ZGJEDHJA E ANËTARËVE TË KËSHILLIT GJYQËSOR NGA RADHËT E GJYQTARËVE

Duke vepruar sipas vendimit të Gjykatës Administrative, KGJRMV, në fillim të janarit 2024, u konkludua se vendimi për shkarkimin e Vesna Damevës ishte anuluar dhe se vendimi i vitit 2022, me të cilin ajo u zgjodh kryetare e KGJRMV-së, mbeti në fuqi. Në të njëjtën seancë, kryetari i atëhershëm Sashko Georgiev paraqiti një kërkesë për përfundimin e mandatit të tij si kryetar i KGJRMV-së, dhe kjo u konstatua në seancë. Në këtë mënyrë, kriza disa mujore në KGJRMV e shkaktuar nga shkarkimi i paligjshëm i kryetares Vesna Dameva u përmbyll me sukses.

Në fillim të vitit 2024, KGJRMV kishte mungesë të një anëtari në radhët e gjyqtarëve nga GJSRMV. Janë publikuar tre shpallje në të cilat nuk kishte aplikuar asnjë kandidat. Gjatë janarit 2024, u konstatua përfundimi i detyrës gjyqësore për shkak të përmbushjes së kushteve për pension moshe të gjyqtares Meri Radevska, e cila ishte zgjodhur anëtare e KGJRMV-së nga radhët e gjyqtarëve nga Rrethi i Apelit të Manastirit.

Disa kandidatë janë paraqitur në shpalljet e publikuara për zgjedhjen e anëtarëve të KGJRMV-së nga radhët e gjyqtarëve të GJSRMV-së dhe nga Rrethi i Apelit të Manastirit. Dy kandidatë - gjyqtarët Cvetanka Periq dhe Isamedin Limani - janë regjistruar në GJSRMV. Aleksandar Kambovski, Tatjana Susuleska dhe Aleksandra Pop Stefania u paraqitën nga Rrethi i Apelit të Manastirit. Gjatë përcaktimit të listave të kandidatëve nga KGJRMV-së, në seancë u zhvillua debat rreth zgjidhjes ligjore dhe interpretimit të saj, si dhe lidhur me numrin e anëtarëve të KGJRMV-së që janë anëtarë të komuniteteve jo-shumicë.

Gjegjësisht, u ngrit pyetja nëse një gjyqtar që u përket të gjitha komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut mund të shfaqet në listën e përgjithshme, kur në Ligjin për KGJRMV ekzistojnë dy lloje të listave - një listë e përgjithshme dhe një listë e vetme e veçantë për anëtarët e të gjitha komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në të cilën shfaqen gjyqtarë - kandidatë për anëtarë të KGJRMV nga komuniteti maqedonas dhe nga komunitetet e tjera që nuk janë shumicë. Rreth kësaj çështjeje është zhvilluar diskutim midis neneve në dy drejtime dhe njëra prej tyre vlerësoi se për shkak të numrit të saktë të përcaktuar të anëtarëve të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kushtetutë dhe në Ligjin për KGJRMV, nuk është e mundur që një anëtar i një komuniteti që nuk është shumicë të paraqitet në listën e përgjithshme, sepse ekzistojnë pengesa kushtetuese dhe ligjore kandidati Isamedin Limani, gjyqtar i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në këtë rast të veçantë të jetë kandidat në Listën e Përgjithshme për kandidatët nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Anëtarët e tjerë vlerësuan se asnjë gjyqtar i GJSRMV-së nuk mund t'i ndalohet të

paraqitet në shpallje, pavarësisht nëse është një listë e përgjithshme ose e veçantë, sepse në Ligjin për KGJRMV, duke pasur parasysh se për anëtar të KGJRMV-së nga radhët e gjyqtarëve të GJSRMV, vetëm gjyqtarët e GJSRMV mund të emërohen dhe zgjidhen, dhe për këtë arsye neni 6 i Ligjit për KGJRMV nuk duhet të interpretohet, por çdo gjyqtar duhet të lejohet të paraqitet si kandidat për anëtar të KGJRMV-së përderisa plotëson kërkesat e Ligjit për KGJRMV[2].

Ligji për KGJRMV[3], në nenin 6, paragrafi 1, rreshti 2 përcakton se " - tetë anëtarë të Këshillit zgjedhin gjyqtarë nga radhët e tyre, me ç'rast tre nga anëtarët e zgjedhur janë anëtarë të komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të cilat do të respektojnë përfaqësimin adekuat dhe të barabartë të qytetarëve që u përkasin të gjitha komuniteteve". Duke pasur parasysh se formulimi i njëjtë është paraparë në Kushtetutë, në nenin 104, disa anëtarë të KGJRMV-së kanë vlerësuar se gjatë përgatitjes dhe përcaktimit të listave të kandidatëve, KGJRMV-ja ka qenë e obliguar, në çdo rast individual, të marrë parasysh përbërjen dhe numrin e anëtarëve, të cilat janë të mandatuar me dispozitat e Kushtetutës dhe ligjit, dhe nuk është e rastësishme dhe nomoteknike që çështja e përbërjes së Këshillit të rregullohet para procedurës për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit, që do të thotë se duhet t 'i kushtohet vëmendje zgjidhjes kushtetuese dhe ligjore për numrin dhe përbërjen e KGJRMV-së.

Në kohën e publikimit të shpalljes për zgjedhjen e anëtarëve të KGJRMV[4] nga radhët e gjyqtarëve, janë gjashtë anëtarë të zgjedhur nga radhët e gjyqtarëve, tre prej të cilëve janë maqedonas, dhe tre të tjerët janë anëtarë të komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (dy nga komuniteti shqiptar, dhe një vlleh sipas kombësisë), që do të thotë se tashmë është siguruar kuota e tre anëtarëve të KGJRMV-së, të zgjedhur nga radhët e gjyqtarëve, për anëtarët e komuniteteve që nuk janë shumicë.

Pas një diskutimi të gjatë dhe pas shprehjes së mendimeve dhe deklaratave të kundërtsa nga anëtarët e KGJRMV-së, duke përfshirë edhe atë nëse një gjyqtar i cili është i regjistruar si shqiptar (ose i një etnie tjetër) mund të aplikojë në listën e përgjithshme të shumicës, megjithatë u përcaktuan kandidatët e mëposhtëm për anëtarë të KGJRMV-së nga radhët e gjyqtarëve

Lista e përgjithshme për kandidatët nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut

- Cvetanka Periq – Gjyqtare e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe
- Isamedin Limani – Gjyqtar i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Lista e përgjithshme për kandidatët nga Rrethi i Apelit të Manastirit

- Aleksandar Kambovski – Gjyqtar i Gjykatës së Apelit të Manastirit
- Aleksandra Pop Stefania – Gjyqtare e Gjykatës Themelore në Ohër dhe
- Tatjana Susuleska – Gjyqtare e Gjykatës të Apelit të Manastirit.

Përpara zgjedhjeve për anëtarë të KGJRMV nga radhët e gjyqtarëve, kandidatja nga GJSRMV - gjyqtarja Cvetanka Periq informoi se po tërhiqte kandidaturën e saj për anëtare të

2 Neni 11 dhe neni 12 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 109/2019

3 Neni 6 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.109/2019

4 Shpallje publike botuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.28 të datës 07.02.2024

KGJRMV për arsye shëndetësore. Anëtarët e KGJRMV-së diskutuan për këtë situatë të re, e cila fatkeqësisht nuk është rasti i parë kur zgjidhet anëtar i KGJRMV-së. Disa pyetje u ngritën në mënyrë legjitime nga anëtarët e KGJRMV-së nëse kandidatja që po tërhiqet nga zgjedhjet për arsye shëndetësore mund të vazhdojë të kryejë funksionin të gjyqtares, si dhe arsyet e tërheqjes së saj që u lidhën me presione të mundshme, për të cilat KGJRMV nuk ka marrë ndonjë denoncim, dhe për këtë arsye nuk mund të angazhohet në shqyrtimin e tyre. Duke qenë se të gjitha materialet tashmë ishin përgatitur për zhvillimin e zgjedhjeve, KGJRMV vendosi që kandidatja Cvetanka Periq të mbetej ende në fletëvotim.

Zgjedhjet për anëtarë të KGJRMV-së nga radhët e gjyqtarëve nga GJSRMV dhe nga Rrethi i Apelit të Manastirit u zhvilluan më 6 qershor 2024 dhe nuk u vërejtën probleme, as ankesa të paraqitura në këtë proces zgjedhor.

Gjyqtari Isamedin Limani është zgjedhur anëtar i KGJRMV-së nga radhët e gjyqtarëve të GJSRMV-së me 7 vota. Në Regjistrin Gjyqësorë, numri i gjyqtarëve të regjistruar për GJSRMV ishte 15, nga të cilët 11 gjyqtarë ushtruan të drejtën e votës, dhe 4 fletëvotime ishin të papërdorura. Dy fletëvotime ishin të pavlefshme. Pavarësisht dorëheqjes, kishte dy vota për kandidaten - gjyqtaren Cvetanka Periq. Në këtë rast, gjyqtari Isamedin Limani pranoi të mos përdorë masat afirmative që përcaktohen nga listat shtesë për pakicat dhe kështu ai nuk do të kishte të drejtë të votonte në kuadër të "shumicës së Badinterit" në zgjedhjen e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, por vota e tij do të ishte e barabartë me anëtarët e tjerë të zgjedhur në listën e përgjithshme pavarësisht nga fakti se gjyqtari është i regjistruar si shqiptar në Regjistrin Zgjedhor të Gjyqtarëve.

Aleksandar Kambovski - gjyqtar i Gjykatës së Apelit Manastir, u zgjodh si anëtar i KGJRMV-së nga radhët e gjyqtarëve nga Gjykata e Apelit e Manastirit, me 28 vota. Numri i gjyqtarëve të regjistruar në Regjistrin Gjyqësor për rrethin e apelit të Manastirit ishte 43, nga të cilët votuan 42 gjyqtarë, dhe një fletë votimi ishte e papërdorur. Një fletëvotim ishte i pavlefshëm. Për kandidaten - gjyqtare Tatjana Susuleska, votuan 10 gjyqtarë, ndërsa kandidatja - gjyqtare Aleksandra Pop Stefania mori 3 vota.

Në përputhje me legjislacionin ekzistues, nuk ka asnjë dispozitë që rregullon regjistrimin e votimit, kështu që të dy kandidatët për anëtarë të KGJRMV-së zgjidhen në përputhje me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.



VENDIM MBI KËRKESËN PËR HEQJEN E IMUNITETIT DHE MIRATIMIN E PARABURGIMIT

KGJRMV për herë të parë miratoi Vendimin për miratimin e paraburgimit të gjyqtarit, pra njëkohësisht vendosi heqjen e imunitetit të tij, miratimin e kërkesës për paraburgim dhe largimin e përkohshëm nga ushtrimi i funksionit gjyqësor, duke respektuar dispozitat ligjore dhe ushtrimin e juridiksionit të KGJRMV-së.[5] Deri më tani, nuk është vërejtur asnjë rast që KGJRMV të zbatojë plotësisht këto dispozita ligjore, edhe pse ato nuk janë mjaft të sakta, por në këtë rast KGJRMV jo vetëm që i hoqi imunitetin gjyqtarit, por edhe miratoi kërkesën për përcaktimin e paraburgimit. Deri më tani, asnjë përbërje e Këshillit Gjyqësor nuk e ka bërë këtë. Dhe pse nuk e ka bërë? Për shkak se formulimi i dispozitës të nenit 99, pika 2 nuk

5 neni 36 paragrafi 1, pika 8,9 dhe 12, neni 99 i Ligjit për KGJRMV-në

është terminologjikisht e përshtatshme me kuptimin “miratimi i paraburgimit për gjyqtar”, KGJRMV ka marrë vendimin me një sqarim specifik se kjo është bërë për të mos penguar procedurën penale, duke qenë se gjyqtari është zënë gjztë kryerjes së një krimi dhe duke respektuar dispozitat dhe afatet e paraburgimit në këtë pjesë të procedurës penale.

Në këtë rast, ne mund të vëzhgojmë sjelljen e ligjshme, në kohë dhe transparente të KGJRMV-së kur vendos të kërkojë heqjen e imunitetit, ndalimin dhe largimin e përkohshëm nga funksioni gjyqësor, i cili është një hap në luftën kundër korrupsionit dhe kështu ndikon në perceptimin negativ të një gjyqësori të pavarur dhe të paanshëm.



ZGJEDHJA E GJYQTARËVE DHE KRYETARËVE TË GJYKATAVE

Në shkurt të vitit 2024, KGJRMV shqyrtoi çështjen e mënyrës së veprimit të KGJRMV-së pas miratimit të Vendimit të Parlamentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për shpalljen e zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare. Gjegjësisht, në përputhje me rekomandimin e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK), për zbatimin e qëndrueshëm të nenit 8-a të Kodit Zgjedhor, i cili përcakton se "nuk mund të fillojë një procedurë për punësimin e personave të rinj ose një procedurë për ndërprerjen e punësimit në institucionet shtetërore dhe publike, ndërsa procedurat e filluara lihen në pritje, përveç në rastet e çështjeve urgjente", anëtarët kanë diskutuar gjatë veprimin në lidhje me këtë rekomandim, gjegjësisht se çfarë do të thotë kjo për aktivitetet e rregullta të KGJRMV-së. Disa nga anëtarët ishin të bindur se nuk ka bazë për interpretimin e këtij neni të Kodit Zgjedhor dhe Rekomandimit të KSHPK-së, sepse është e qartë dhe duhet të respektohet, domethënë të ndalohen të gjitha aktivitetet e KGJRMV-së në lidhje me emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve/kryetarëve të gjykatave në periudhën zgjedhore. Nga ana tjetër, disa nga anëtarët nuk u pajtuan plotësisht me zbatimin e këtij neni, sepse ky kufizim nuk zbatohet për gjyqësorin, i cili është një nga tre pushtetet, i pavarur nga dy të tjerët, dhe të njëjtat rregulla nuk mund të zbatohen për gjyqësorin, sepse KGJRMV nuk mirret me punësime, gjegjësisht shkarkime të gjyqtarëve ose kryetarëve të gjykatave. Bëhet fjalë për procedura që zgjasin një kohë të gjatë, si dhe për shpallje që janë publikuar shumë më herët se vendimi i Parlamentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. E njëjta gjë vlen edhe për procedurat e shkarkimit nga puna. Këto janë procedura të zgjatura që kanë faza të shumëfishta dhe nëse ndalohen të gjitha aktivitetet, KGJRMV nuk do të jetë në gjendje të kryejë kompetencat e tij themelore për një periudhë shumë të gjatë.

Për shkak të pamundësisë për të marrë një vendim unanim, KGJRMV për këtë çështje të nxetë solli Konkludim për të pezulluar procedurat për përcaktimin e përgjegjësisë për gjyqtarin/kryetarin e një gjykate, në rastet kur nuk është krijuar një Komitet i Relatorëve. Procedurat për zgjedhjen e kryetarit të gjykatës/gjyqtarit dhe për publikimin e shpalljes janë pezulluar edhe në rastet kur procedura e përzgjedhjes ka përfunduar.

Pas një periudhe të caktuar kohore, për të mundësuar funksionimin e KGJRMV-së, u korrigjuan konkludimet në lidhje me zbatimin e rekomandimit të KSHPK-së dhe u miratuan konkludime që i nxorën jashtë fuqisë konkludimet e miratuara më parë, përveç në situata urgjente kur mund dhe duhet të ndërmerren veprime. U vendos që procedura për zgjedhjen e anëtarëve të KGJRMV-së nga radhët e gjyqtarëve të GJSRMV-së dhe të Rrethit të Apelit të Manastirit të vazhdojë.

Bazuar në këto konkluzione, brenda një periudhe tre mujore, KGJRMV nuk ka zgjedhur gjyqtarë, megjithëse procedurat në lidhje me shpalljet aktive ishin pothuajse gati. U zhvilluan aktivitete përgatitore, gjegjësisht u bë renditja ekandidatëve për gjyqtarë në një gjykatë më të lartë, pas shpalljeve të publikuara para miratimit të vendimit të Parlamentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për shpalljen e zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare nga shkurti 2024.

Megjithatë, në këtë periudhë raportuese, u zgjodhën 3 gjyqtarë të rinj, një në Gjykatën e Apelit të Gostivarit (12.2.2024) dhe dy në Gjykatën e Apelit të Shtipit (13.2.2024).

Në njoftimin për zgjedhjen e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit në Gostivar, janë paraqitur gjithsej 3 kandidatë nga zona penale. Si gjyqtare e Gjykatës së Apelit Gostivar, për zonën penale, u emërua Emine Murati, gjyqtare e Gjykatës Themelore Gostivar.

Në shpalljen për zgjedhjen e gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Shtip janë paraqitur gjithsej 8 kandidatë, nga të cilët 5 për zonën penale dhe 3 për zonën civile. Si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shtip, për zonën penale, u emërua Gjorgji Andonov, gjyqtar i Gjykatës Themelore Shtip, ndërsa si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shtip, në zonën civile, u emërua Todor Pop Panev, gjyqtar në Gjykatën Themelore Shtip.

Në seancat, për secilin kandidat individualisht, u referuan rqaportua për pikët që morën. Bazuar në pikët e marra nga e gjithë procedura e vlerësimit, është bërë një renditje e votimeve, duke filluar nga kandidati që ishte i pari në listë me numrin më të lartë të pikëve. Në përputhje me ligjin, si i zgjedhur konsiderohet kandidati që ka marrë 8 vota nga anëtarët e KGJRMV me të drejtë vote. Pasi të zgjidhet numër i mjaftueshëm kandidatësh, të kërkuar sipas shpalljes, ndërpritet votimi i mëtejshëm dhe nuk jepet mundësia për të votuar për kandidatët e tjerë dhe për të shteruar të gjithë listën. Për shkak të dispozitave ligjore, kjo praktikë është e pranishme në KGJRMV dhe lind përsëri pyetja nëse një kandidat tjetër nga renditja mund të marrë numrin e njëjtë ose edhe më të madh të votave sesa kandidati i mëparshëm i votuar tashmë nga anëtarët e KGJRMV. Megjithatë, për shkak të kritikave nga publiku, si dhe rekomandimeve nga Misioni vlerësues dhe ndryshimet në Rregulloren e punës së KGJRMV-së, pritet që kjo praktikë aktuale të ndryshojë.

Ajo që bie në sy në lidhje me zgjedhjen e gjyqtarëve janë polemikat që lindin midis anëtarëve të KGJRMV-së kur bëhet fjalë për procedurën e përcaktimit të listës së renditjes së kandidatëve për gjyqtarë pas një shpalljeje të veçantë. Konkretisht, krijohet një Komision për renditjen e kandidatëve për zgjedhjen e gjyqtarëve në një gjykatë më të lartë, i cili kontrollon raportet dhe dokumentet e paraqitura, kështu që nëse ai komision përcakton se ka situata të kontestuara me dokumentet e paraqitura, para se të miratohet raporti me listën e renditjes, kandidatët e kontestuar, pra raportet, shpjegohen në një seancë të KGJRMV-së në të cilën merret një vendim nëse raportet e kontestuara duhet të pranohen si të plota, ose të refuzohen si jo të plota. Për një kohë të gjatë, anëtarët e KGJRMV-së nuk mund të binin dakord nëse dispozitat ligjore duhet të zbatohen "verbërisht", duke deklaruar se cilat dokumente kërkohen të dorëzohen nga kandidati për zgjedhje në një gjykatë më të lartë, së bashku me kërkesën, dhe këto janë dokumente që janë pjesë e dosjes së secilit gjyqtar që KGJRMV mban ex officio (siç është certifikata e shtetësisë, diploma, konfirmimi i kalimit të provimit të avokatisë, etj.). Për shkak të pikëpamjeve të ndryshme të anëtarëve, ku disa besojnë se pavarësisht se cilat dokumente janë të përfshira, kandidati duhet të paraqesë të gjitha dokumentet e renditura në dispozitat ligjore, sepse kjo pasqyron karakterin e gjyqtarit në zbatimin e ligjeve, dhe nga ana tjetër, të tjerët besojnë se nuk ka nevojë për një respektim të tillë kufizues të dispozitave ligjore, sepse është çështje e mosrespektimit

të Ligjit për Gjykatat në Republikën e Maqedonisë së Veriut[6] dhe formalizmit kufizues që duhet të shmanget, veçanërisht kur bëhet fjalë për dokumentet e mbajtura nga KGJRMV në dosjen e secilit gjyqtar. Për këto arsye, u konkludua se nuk kërkohen ato dokumente që posedon KGJRMV, të cilat janë përgjithësisht të njohura dhe pa të cilat gjyqtarët nuk mund të zgjidheshin gjyqtarë, dhe në këto raste bëhet fjalë për ngritjen e tyre në një gjykatë më të lartë. Pra, për zgjedhje në një gjykatë më të lartë, është e nevojshme vetëm paraqitja e atyre dokumenteve që lëshohen nga një autoritet tjetër, të cilat janë pjesë e dokumenteve të kërkuara.

Gjithsesi, pavarësisht konkluzionit të arritur për këtë çështje, anëtarët e KGJRMV-së nuk kanë mbajtur një qasje konsistente dhe ndonjëherë insistojnë që një kandidat t'i ketë të gjitha dokumentet, dhe për tjetër kandidat ata pajtohen se janë fakte të njohura që nuk kanë nevojë t'u bashkëngjiten dokumenteve të aplikimit. Në varësi të përbërjes së Komisionit për Renditjen e Kandidatëve për Zgjedhjen e Gjyqtarëve në një Gjykatë të Lartë dhe në varësi të kandidatëve të regjistruar, pavarësisht nga Konkludimi i miratuar, megjithatë, në çdo raport që rendit kandidatët sipas shpalljes për zgjedhjen e gjyqtarëve në një gjykatë më të lartë, lind pyetja në lidhje me dokumentet e nevojshme, zhvillohen diskutime dhe jo gjithmonë KGJRMV vepron mbi përfundimet që ka arritur më parë.

Nuk ka dyshim se në këtë seksion është i nevojshëm një ndryshim legjislativ, për të unifikuar se cilat dokumente do të kërkohen, por gjithsesi, për të siguruar parashikueshmëri për kandidatët dhe për të shmangur përshtypjen se renditja e kandidatëve po manipulohet, kështillohet që KGJRMV t'i përmbahet konkludimeve të saj, pavarësisht se kush janë anëtarët e komisionit që përzgjedh dhe rendit kandidatët për ngritje në detyrë.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Këshilli Gjyqësor zgjodhi 8 kryetarë të rinj si ushtrues të detyrës, përkatësisht në Gjykatën Themelore të Gostivarit, Gjykatën Themelore të Strugës, Gjykatën Themelore të Manastirit, Gjykatën Themelore të Koçanit, Gjykatën Themelore të Radovishit, Gjykatën Themelore të Strumicës, Gjykatën Themelore të Berovës dhe Gjykatën Themelore të Ohrit.

Është shqetësuese që vazhdon të ketë një tendencë në gjykatat më të vogla se nuk ka kandidatë të interesuar për kryetar.

Për të përcaktuar në detaje numrin e kërkuar të vendeve ttë gjyqtarëve në gjykatat në vend, dhe bazuar në një numër të madh parametrash, KGJRMV, në vitin 2023, përgatiti një Analizë të vendeve të kërkuara në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gjykatën e Lartë Administrative, Gjykatën e Apelit Shkup, Gjykatën e Apelit Manastir, Gjykatën e Apelit Gostivar dhe Gjykatën e Apelit Shtip, Në gjysmën e parë të vitit 2024, ai gjithashtu përgatiti një Analizë të vendeve të nevojshme në Gjykatën Administrative dhe në gjykatat themelore të zonës së apelit të Shkupit, zonën e apelit të Gostivarit, zonën e apelit të Manastirit dhe zonën e apelit të Shtipit, si dhe një Analizë për përcaktimin e numrit të vendeve të lira në gjykatat themelore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, pra mund të konsiderohet se, nga KGJRMV, brenda kompetencave të tyre, është rishikuar rrjeti gjyqësor. Sipas këtyre analizave, ka një mungesë të madhe të gjyqtarëve në këtë moment, kështu që kemi 274 vende të plotësuara në gjykatat themelore, ndërsa 434 gjyqtarë janë të nevojshëm për procedime efektive dhe efikase.

6 Neni 45 i Ligjit për Gjykatat në Republikën e Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë 58/2006)

SHKARKIMI I GJYQTARËVE DHE KRYETARËVE TË GJYKATAVE

Në periudhën deri në korrik 2024, Këshilli Gjyqësor konstatoi ndërprerjen e detyrës gjyqësore për shkak të pensionimit për 15 gjyqtarë, si dhe 1 (një) gjyqtar që ndërpreu detyrën gjyqësore me kërkesën e tij dhe një gjyqtar që ndërpreu detyrën gjyqësore për shkak të zgjedhjes në një institucion tjetër shtetëror, , duke vazhduar kështu trendin e mungesës së gjyqtarëve në gjykatat themelore dhe të apelit.

Gjatë kësaj periudhe, Sofia Spasovska Medarska, e cila u zgjodh anëtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në dhjetor 2023, u shkarkua nga posti i saj si gjyqtare, ndërsa duhej të merrte detyrën në shkurt 2024. Ajo paraqiti kërkesë për pezullimin e funksionit të gjyqtares, bazuar në dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Punës, duke iu referuar edhe praktikës aktuale të KGJRMV-së për miratimin e pezullimit të funksionit gjyqësor të disa gjyqtarëve. KGJRMV nuk e ka miratuar këtë kërkesë, referuar dispozitave në ligjin për KGJRMV[7] që tregojnë se përfundimi i funksionit gjyqësor të gjyqtarit do të përcaktohet kur ai zgjidhet ose emërohet në një detyrë tjetër publike, përveç në rast se ligji parashikon pezullimin e funksionit gjyqësor, në ditën e zgjedhjes, domethënë me emërimin.

I njëjti mendim mbizotëronte midis anëtarëve të KGJRMV-së për këtë çështje, por megjithatë, shumica e anëtarëve iu referuan dispozitave të Ligjit për Gjykatat ku shkruhet se "funksioni gjyqësor është i papajtueshëm me funksionin e deputetit, domethënë anëtar i këshillit të një komune, domethënë me qytetin e Shkupit dhe me funksionet në organet shtetërore, komunën dhe qytetin e Shkupit".[8]

Në gjysmën e parë të vitit 2024, KGJRMV mori 7 (shtatë) vendime për pezullimin e procedurave për përgjegjësinë e gjyqtarit/kryetarit të një gjykate, pastaj 2 (dy) vendime për tërheqjen e kërkesave për përgjegjësinë e gjyqtarit/kryetarit të një gjykate dhe shqiptoi 3 (tre) masa disiplinore për uljen e pagës së gjyqtarëve, dhe bazuar në Kërkesat për fillimin e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarëve ose kryetarit të një gjykate, KGJRMV përkohësisht largoi një gjyqtar të GJSRMV-së nga kryerja e funksionit gjyqësor deri në përfundimin e procedurës penale.

Për shkak të shpalljes së zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare dhe të gjithë procesit zgjedhor, disa nga procedurat për llogaridhënien e gjyqtarit/kryetarit të një gjykate u pezulluan.

MONITORIMI I PUNËS SË GJYKATAVE

Monitorimin e punës të gjykatave KGJRMV e bën përmes shqyrtimit dhe vlerësimit të raporteve tremujore dhe vjetore, por edhe me vizita në gjykata nga komisione të përbëra nga anëtarë të Këshillit Gjyqësor, i cili parashikohet në Planin e Brendshëm për monitorimin dhe vlerësimin e punës së gjykatave, gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave për vitin 2024 dhe Planin e Veprimit që është pjesë përbërëse e Planit të Brendshëm të miratuar në mars 2024[9].

7 Nenet 54 dhe 59 të Ligjit për KGJRMV

8 Neni 52 i Ligjit për Gjykata (Gazeta zyrtare e RMV nr. 58/2006)

9 www.sud.mk

Nga raportet tremujore për punën e gjykatave mund të konstatohet se trendi i gjykatave të jopërditësuara vazhdon dhe arsyet për këtë gjendje janë zvogëlimi i numrit të gjyqtarëve, numri i pamjaftueshëm i administratës gjyqësore dhe rritja e numrit të lëndëve.

Praktikë e zakonshme është që pas vizitave në gjykata, anëtarët e komisionit që kanë kryer vizitën e prezantojnë në seancë raportin e vizitës, duke evidentuar gjetjet më domethënëse që kanë arritur dhe duke propozuar konkludime për veprime të mëtejshme nëse janë konstatuar mangësi në funksionimin e gjykatës ose të disa gjyqtarëve ose kryetarëve të gjykatave. Nëse lind nevoja, ndodh që të bëhet një vizitë e jashtëzakonshme në gjykatë, dhe arsyet për këtë janë më së shpeshti lëndët gjyqësore me interes për publikun ose parashtresat nga qytetarët ose personat juridikë. Kështu, gjatë kësaj periudhe raportuese, u kryen vizita në gjykata, dhe në seancë u paraqitën dhe u miratuan raportet nga vizitat e punës në Gjykatën Themelore të Manastirit, Gjykatën Themelore të Tetovës, Gjykatën Themelore të Ohrit, si dhe raportet nga vizitat e punës në Gjykatën e Apelit Shkup, Gjykatën e Apelit Gostivar dhe Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

VENDIMMARRJE PËR PARASHTRESAT NGA QYTETARËT DHE PERSONAT JURIDIKË

Parashtresat e qytetarëve dhe subjekteve juridike që i parashtrohen KGJRMV-së, e që kanë të bëjnë me punën e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, shqyrtohen dhe zgjidhen rregullisht në përputhje me afatet ligjore.

Në gjysmën e parë të vitit 2024 janë shqyrtuar rreth 240 parashtresa të paraqitura nga qytetarë dhe personat juridikë.

Këshilli Gjyqësor i hedh poshtë si të pabaza numrin më të madh të parashtresave, duke pasur parasysh se me parashtresat qytetarët, pra personat juridikë kërkojnë ndryshimin e vendimit të gjykatës, sepse nuk janë të kënaqur me të . Në shumicën e rasteve, Këshilli Gjyqësor konstaton se procedimi i lëndës bazohet në ankim në gjykatën e shkallës së dytë, kështu që gjykata e shkallës së dytë do t'i vlerësojë pretendimet në peticion si pretendime ankimore në procesin e vendimmarrjes, dhe si rrjedhojë nuk ka kompetencë të ndërhyjë në vendime gjyqësore, as t'i ndryshojë ato, duke mos konstatuar arsye për veprim ".

Mund të vërehet edhe refuzimi i parashtresave gjithashtu, dhe arsyeja kryesore e refuzimit është mungesa e fakteve të reja në lidhje me parashtresën e paraqitur, pastaj fakti që parashtresa tashmë është shqyrtuar në një nga seancat e mëparshme ose për shkak se nuk përmban të gjitha të dhënat që janë të nevojshme për t 'u shqyrtuar.

Vazhdon trendi i rritjes së numrit të parashtresave të bazuara nga KGJRMV. Parashtresat që anëtarët e KGJRMV do t'i konstatojnë se janë me bazë përmbajnë më shumë prova nga të cilat gjatë studimit mund të përcaktojnë indikacione të punës së pamatur ose joprofesionale të një gjyqtari. E rëndësishme për këto parashtresa është se, kur bëhet fjalë për një ankesë në të cilën gjyqtari ka tejkaluar afatet për të vepruar, ose për publikimin e vendimit, ose për hartimin e vendimit, anëtarët e KGJRMV-së e konkludojnë këtë. Një nga arsyet e këtij veprimi është se ky qëndrim bie brenda kritereve të vlerësimit të gjyqtarëve, në përputhje me Metodologjinë e vlerësimit të tyre. Pas shqyrtimit të plotë të parashtresave për të cilat ka indikacione se janë me bazë, anëtarët e KGJRMV-së mund të fillojnë edhe procedurën për përgjegjësi të gjyqtarit/kryetarit të gjykatës. Në rastet kur bazat e paraqitura në

parashtresa nuk janë të mjaftueshme për fillimin e procedimit për përgjegjësinë e gjyqtarit/kryetarit të gjykatës në fjalë, parashtresat me bazë do të jenë pjesë e vlerësimit të gjyqtarit/kryetarit të gjykatës.

Gjatë kësaj periudhe, mund të vërehet se parashtresat trajtohen në mënyrë jokonsistente për sa i përket bazave, pastaj se ndonjëherë parashtresat shumë të ngjashme vendosen ndryshe, domethënë se një mendim i miratuar më parë ndryshohet pa shpjegim.

PËRFUNDIME



Në periudhën nga janari deri në korrik 2024, KGJRMV ishte nën presion të madh nga publiku, nga ekspertët vendas dhe nga OJQ-të, mediat dhe institucionet ndërkombëtare me qëllim të rivendosjes së besimit në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe legjitimitetit të tyre si organi më i lartë në gjyqësor, me kthimin e kryetares Vesna Dameva.



Transparenca e përgjithshme e rritur e KGJRMV-së është e dukshme përmes një numri publikimesh në faqen e tyre të internetit, me informacion në kohë për seancat, për vendimet e marra pas seancave dhe me njoftime nga seancat që janë më të gjera dhe që përmbajnë detaje rreth pikave të diskutuara në seanca.



Këshilli Gjyqësor ka kryer rregullisht punën e tij në lidhje me trajtimin e parashtresave, me emërimin e gjyqtarëve në gjykatat themelore, vizitat e punës në gjykata, vlerësimin e rregullt të gjyqtarëve, si dhe me kontrollin e punës së gjykatave përmes vizitave dhe raporteve tremujore.



Disa tema mbeten të hapura për sa i përket efektivitetit dhe efikasitetit, por edhe për reputacionin dhe besimin midis gjyqtarëve dhe publikut, si dhe për trajtimin jo konsistent të anëtarëve të KGJRMV në zbatimin konsistent dhe në të gjitha rastet të kushteve në lidhje me dokumentet e listuara të nevojshme për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave.



Përcaktimi i një numri më të madh të parashtresave nga qytetarët me baza të mira është pozitive, pasi Këshilli Gjyqësor mund t'i marrë parasysh ato gjatë përcaktimit të indikacioneve të punës së pamatur dhe joprofesionale të një gjyqtari. Por praktika e vendosur duhet të zbatohet vazhdimisht kur vendoset për gjetje të njëjta ose të ngjashme pas parashtresave.



Gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve në një gjykatë më të lartë, rang-listat e përgatitura në përputhje me procedurën e parashikuar për ngritje në detyrë nuk zgjedhin gjyqtarët e rangut të parë, por gjyqtarët e rangut më të ulët, për të cilët shpjegimi është dhënë vetëm nga disa anëtarë të KGJRMV-së se pse duhet të ngrihen në detyrë ata gjyqtarë. Me miratimin e ndryshimeve në Rregulloren e punës së KGJRMV-së dhe me ndryshimin e Rregullores për mënyrën e renditjes së kandidatëve për zgjedhje në një gjykatë më të lartë, në periudhën vijuese, mbetet të monitorohet zbatimi i këtyre ndryshimeve.



Si çështje e hapur, në zgjedhjen e gjyqtarëve, përfundimi me votim të mëtejshëm pas përzgjedhjes së një numri të mjaftueshëm kandidatësh sipas shpalljes, ndërsa kandidatëve të tjerë në renditje nuk u jepet mundësia për t'u votuar dhe për të marrë të njëjtat ose më shumë vota. Mungesa e kandidatëve në shpallje për gjykatat më të vogla, e cila zvarritet për një kohë të gjatë, ndikon në punën e këtyre gjykatave dhe është një çështje që duhet të merret parasysh gjatë miratimit të dokumenteve strategjike dhe ndryshimeve ligjore.



Besimi në Këshillin Gjyqësor, i cili është dukshëm në një nivel relativisht të ulët, duhet së pari të rritet midis vetë gjyqtarëve, dhe më pas nga publiku i gjerë.

REKOMANDIME

Bazuar në monitorimin e seancave të hapura të Këshillit Gjyqësor, raporteve për Këshillin Gjyqësor, publikimeve dhe dokumenteve të publikuara në faqen e internetit të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe publikimeve në media, mund të bëhen rekomandimet e mëposhtme:



Këshilli Gjyqësor i hedh poshtë si të pabaza numrin më të madh të parashtresave, duke pasur parasysh se me parashtresat qytetarët, pra personat juridikë kërkojnë ndryshimin e vendimit të gjykatës, sepse nuk janë të kënaqur me të .



Këshilli Gjyqësor duhet të zbatojë në mënyrë të vazhdueshme dokumentet që ka miratuar, që rezultojnë nga miratimi i rekomandimeve të Misionit Vlerësues të BE-së në Republikën e Maqedonisë së Veriut.



Në periudhën e ardhshme, Këshilli Gjyqësor duhet të përqendrojë kapacitetet e tij në rritjen e besimit të qytetarëve në gjyqësor përmes një roli proaktiv dhe marrjes së masave për të zvogëluar perceptimin e korrupsionit në gjyqësor.



Këshilli Gjyqësor duhet të zbatojë vazhdimisht dispozitat e akteve të reja të miratuara gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve në gjykatat më të larta dhe të japë arsye specifike pse një gjyqtar nga lista e rangimit nuk është zgjedhur në një gjykatë më të lartë.



Këshilli Gjyqësor duhet të punojë për rritjen e besimit të gjyqtarëve përmes zbatimit të vazhdueshëm të dispozitave ligjore.